



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 23.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 18.08.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “D & T Group” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me autoambulanca” me nr prokurimi 206-23-5211-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “D & T Group” SH.P.K. e dt. 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me autoambulanca” me nr prokurimi 206-23-5211-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 16.08.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Mbeten në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 16.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, e konsideron të anuluar aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “D & T Group” SH.P.K. me datë 18.08.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me autoambulanca” me nr prokurimi 206-23-5211-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 22.08.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 23 Zyrtarët e Prokurimit

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullorja për PP, nr 001/2022

Neni 11 Funksionet e Departamentit /Njesisë së Prokurimit
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 43 Ndërprenja e procedurave të prokurimit
Neni 97 Shkeljet e rënda

Pretendimet ankimore – Deklarate mbi faktet dhe argumentet, sipas OE ankues:

Me datën 16.08.2023, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku është kërkuar anulimi i aktivitetit të prokurimit: “Furnizim me Autoambulanca” me nr prokurimi: 206-23-5211-1-1-1.

Ndërsa ne letër standarde, kundrejt ofertës së Operatorit Ekonomik: “D&T Group shpk, si arsytim të eliminimit keni përcaktuar: “Oferta e juaj është e pa përgjegjshme meçe nuk keni plotësuar kriterin: 2. Autorizim nga prodhuesi (ose dilerit që është i autorizuar nga prodhuesi) se jeni i autorizuar për shitjen dhe servilizmin e Autoambulancave që ofertoni. – Kopje e noterizuar. Keni ofertuar me prodhuesin PEUGEOT, nga Franca. I autorizuar nga Peugeot, si distributor për Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Kosove dhe Shqipëri është EUROIMPEX DOO Skopje, i cili e ka autorizuar Mercom Company që të marr pjesë në tender, të negocioj dhe të nënshkruaj kontrate që ta furnizoj autoritetin kontraktues me automjetet e Peugeot.

Mercom Company shpk, nuk ka ofertuar vet në tender, por autorizimin e ka bart tek ju D& T Group shpk, ndërsa ju nuk keni autorizim as nga prodhuesi Peugeot as nga distributori Euroimpex Doo Skopje sic është kërkuar.

Oferta e juaj është e pa përgjegjshme meqenëse nuk e plotësoni kriterin 8. OE duhet të dorëzoj vërtetim nga prodhuesi se do të mbështes distributorin e OE për se paku 10 vite me pjese rezerve për autoambulance dhe 7 vite për pajisje mjekësore. Dëshmia Kopja e vërtetimit nga prodhuesi”.

Pretendimi ankimore 1.

Operatori Ekonomik D&T Grupup, shpk, pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, në afatën parapare me dispozitat e nenit 108/A, të LPP-se, e kundërshton arsyetimin e eliminimit sipas letrës standarde, pasi që ju si Autoritet Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, në dosje të tenderit sa i përket pikës 1, të eliminimit, tek kërkesat e

kapacitetit teknik dhe profesional si dëshmi keni kërkuar:

“Autorizim nga prodhuesi (ose dileri qe është i autorizuar nga prodhuesi) se jeni te autorizuar për shitje servisimin e autoambulancave qe ofertoni – Kopje e noterizuar.

Operatori Ekonomik “D&T Group” shpk, për këtë procedurë te prokurimit, ne oferte kemi prezantuar dëshmi përmes te cilave vërtetohet se plotësohet kërkesa kualifikuese, përkatësisht ne oferte kemi prezantuar Letër Autorizimin e datës 04.07.2023, nga dileri “Mercom Company” shpk, i autorizuar nga distributori “Euroimpex”, i prodhuesit Peugeot.

Ne letër konfirmimin e datës. 06.01.2020 te distributorit Euroimpex”, përveç tjerash potencohet se, “Mercom Company” shpk, është përfaqësues i autorizuar, për shitjen e automjeteve te reja dhe për servisim te produkteve te prodhuesit Peugeot, per pjese rezerve, përkatëse për territorin e Republikës se Kosovës, ku i njëjti është i autorizuar te marr pjese, te negocioj dhe te bart te drejta, rrjedhimisht është e autorizuar qe te beje mirëmbajtjen dhe te ofroj garanci tek autoritetet kontraktore.

- Prove: Letër Autorizimi i dilerit i datës 04.07.2023, i noterizuar dhe konfirmimi i distributorit i datës 06.01.2020.

Pretendimi ankimor 2.

Sa i përket arsytimit te eliminimit 2, ne si Operator Ekonomik, po ashtu ne oferte kemi prezantuar fakte dhe prova shkresore ku, kemi plotësuar kërkesën e pozicionit nr. 8, te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar: “OE duhet te dorëzoj Vërtetim nga prodhuesi se do te mbështes distributorin e OE për se paku 10 vite me pjese rezerve për autoambulance dhe 7 vite për pajisje mjekësore”, ndërsa si dëshmi dokumentare është përshkruar: “Kopje e vërtetimit nga prodhuesi”.

Operatori Ekonomik, ne oferte ka prezantuar, dëshmi për garancinë edhe ndaj pajisje mjekësore sipas kërkesës se përcaktuar. Pra behet fjale për mbindërtim dhe pajisje shtese, e cila modifikohet dhe inkorporohen ne pajisjen kryesore apo autoambulancën. Ne si kompani kemi ofruar dëshmi dhe garancinë sipas periudhës se kërkuar nga ju si AK, përkatësisht sipas Autorizimit te datës 03.07.2023, te prodhuesit “Fazzini”, Autorizimit te datës 07.04.2023, te prodhuesit “Gima”, dhe autorizimin e datës 30.06.2023, te prodhuesit “Progetti”, prodhues te pajisjeve mjekësore, te konfirmuara edhe nga anëtarët e komisionit vlerësues te ofertave ku neve si operator ekonomik “D&T Group” shpk, jemi kualifikuar si te përgjegjshëm dhe jemi rekomanduar për dhënie me datën. 16.08.2023.

- Prove: Raporti i vlerësimit te ofertave i datës 16.08.2023, dhe letër autorizimet për produktet mjekësore.

Neni 23, paragrafi 4 pika (ii) dhe (iii) i LPP-se, përcaktojnë:

(ii) zyrtar i prokurimit do të ushtrojë aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues në mënyrë të ndershme dhe të ndërgjegjshme dhe në pajtim të plotë me këtë ligj, dhe (iii) menjëherë do të ushtrojë në mënyrë profesionale të gjitha detyrat tjera të përcaktuara në këtë ligj.

Ne anën tjetër neni 59, i LPP-se, paragrafi 1 përcakton: “Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës...”.

Pra zyrtari përgjegjës i prokurimit, ne kundërshtim me dispozitat ligjore parimet e prokurimit publik, kodin etik të prokurimit publik, ndërhyjnë në proces kundërligjshëm dhe tentimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin e dhënë si në letër standarde.

Pretendimi ankimor 3.

Pas konstatimit të anëtareve të komisionit vlerësues të ofertave dhe rekomandimit për dhënie të kontratës anulimi i aktivitetit të prokurimit me arsyetim se në nuk i plotësojmë kërkesat 2 dhe 8 të kapacitetit teknik dhe profesional, paraqet shkelje të rënde të ligjit për prokurim publik sipas pikës k), të përcaktuar me nenin 97, të rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022.

Po ashtu veprimi kundërligjor i zyrtarit përgjegjës të prokurimit, përcaktohet edhe me nenin 39.11, RRPP-se, ku përcaktohet: “...Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

Ndërsa shpjegimet e përshkruara në arsyetimin e dhënë në raportin e vlerësimit të ofertave dhe në letrën standarde, janë devijime nga provat e ofruara nga kompania jone dhe nga kërkesat e përcaktuara nga vet ju si AK, në dosje të tenderit dhe njoftim për kontrate, Shpjegimet e përshkruara si arsyetim të eliminimit të kompanisë sone, nuk raportohet drejt sipas gjendjes faktike dhe ligjore.

Në pikën 2, të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional është dhënë mundësia të ofertohet me diler të autorizuar nga prodhuesi.

Ndërsa në pikën 8 është kërkuar vërtetim nga prodhuesi për mbështetje ndaj distributorit, pra roli i dilerit dhe roli i distributorit kanë dallime dhe do duhej të shpjegohej gjendja faktike sipas kërkesave dhe dëshmive.

Në arsyetim të eliminimit të ofertës sonë zyrtari përgjegjës i prokurimit potencion se “Mercom Company” shpk, nuk ka ofertuar vet, por autorizimin e barte dhe se neve si kompani nuk jemi distributor.

Ligjërish do duhej të vlerësohen ofertat e dorëzuara dhe jo të vlerësohet se kush do duhej të ofertonte dhe kush jo, ndërsa pohimi se kopja e vërtetimit për garancinë është ofruar nga distributori dhe jo nga prodhuesi, këto pohime tregojnë qartë për mos respektim të ligjit dhe parimeve të prokurimit si tërësi, deformim të kërkesave, dëshmive dhe shtrembërim të realitetit.

Shumë qarte, në letrë autorizime dhe konfirmime të prezantuara në oferte përcaktohen, të

drejtat e distributorit dhe delegimi i te drejtave tjera perfshire edhe dhënien e garancionit nga prodhuesi tek distributor, rrjedhimisht edhe tel dileri i autorizuar, ku lejohet dhe mundësohet ofrimi i garancisë servisimit dhe pajisjeve, meçe distributori posedon staf te certifikuar dhe kualifikuar nga prodhuesi, rrjedhimisht eliminimi i ofertës sonë me arsyetim te tille dhe pas konstatimit dhe rekomandimit për dhënie te kontratës nga anëtareve te komisionit vlerësues te ofertave, zyrtarin përgjegjës te prokurimit e implikon ne shkelje ligjore te përcaktuar me nenin 97, te RRPP-se.

Ne rast te pa qartësie, është dashtë te formohet komision i ri sipas bazës ligjore te larte përkruar, përkatësisht te kërkohet sqarim, siç obligojnë dispozitat e nenit 59 dhe 72, te ligjit për prokurim publik.

Eshtë i habitshëm fakti i vlerësimit te njëanshëm dhe dallimit ku kompania jone me datën 24.04.2023, ka lidh kontratë me Autoritetin Kontraktues – Ministrin e Shëndetësisë, me kërkesa kualifikuese identike dhe me Autorizime te njëjta, por ne rastin paraprak jemi rekomanduar dhe kemi lidh kontratë, prova te cilat i posedojmë ne si OE, por edhe ju si AK – Ministria e Shëndetësisë.

Për me tepër edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka gjykuar, për qeshje tipike identike, lidhur me distribuimin dhe dilerin (shoqi vendimin nr. 207/23), madje anulimi i aktivitetit te prokurimit pas hapjes se ofertave dhe rekomandimit te komisionit vlerësues, neve si kompani na detyron qe ne procedurat vijuese ti raportojmë shkeljet, konsistencën dhe për veprimet e njëanshme dhe shkelje te parimeve duhet te kërkojmë nga OSHP dhe KRPP, te zbatojnë dispozitat e nenit 25, paragrafi 8 ndaj zyrtarit përgjegjës te prokurimit.

Bazuar ne faktet, provat dhe dëshmit e prezantuara me larte dhe atyre te bashkangjitura ne oferte, kërkojmë qe AK – Ministria e Shëndetësisë te nxjerr:

V E N D I M

Te aprovohet, kërkesa për ri shqyrtim si e bazuar,
Te anulon, njoftimin për anulim te aktivitetit te prokurimit,
Te vazhdohet me rekomandimin për dhënie te kontratës sipas konstatimeve te komisionit vlerësues te ofertave te datës 16.08.2023,

Ne te kundërtën, ne si OE, disponojmë, prova shkresa dhe dëshmi përmes te cilave vërtetohet e kundërta nga ajo qe është vendosur njëanshëm nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet janë te shumëfishta, ne aspekt moral dhe material, te cilat do ti kalkulojme...

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore

- Nuk pajtohem me pretendimin e juaj ne lidhje me autorizimin për tenderim, duke marre parasysh se ju nuk e keni plotësuar këtë kriter, i cili ka qene i qarte ne NJK dhe DT:

Dëshmia 2. Autorizim nga prodhuesit (ose dilerit qe është i autorizuar nga prodhuesi) se jeni i autorizuar për shitjen dhe servisimin e Autoambulantave qe ofertoni. - Kopje e Noterizuar

Prodhuesi është PEUGEOT nga Franca, ndërsa dileri është EUROIMPEX DOO SKOPJE (I autorizuar nga PEUGEOT si distributor për Maqedoni, Serbi, Mal i Zi, Kosove dhe Shqipëri).

Ne ofertën tuaj ju nuk keni ofruar Autorizim as nga PEUGEOT as nga EUROIMPEX DOO SKOPJE, siç është kërkuar kriteri, por keni prezantuar autorizim nga MERCOM COMPANY SH.P.K. d.m.th. autorizimi juaj është një shkallë me larg (nga dileri Mercom, diler Mercom prej dilerit EUROIMPEX, e ky nga prodhuesi PEUGEOT), andaj nuk e plotësoni kriterin e NJK dhe DT.

- Nuk pajtohem me pretendimin e juaj ne lidhje me vërtetimin e prodhuesit për mbështetje me pjesë rezervë për autoambulancë për së paku 10 vite, duke marre parasysh se ju nuk e keni plotësuar këtë kriter, i cili ka qene i qarte ne NJK dhe DT:

Kërkesa 8. OE duhet te dorëzoj Vërtetim nga prodhuesi se do të mbështesë distributorin e OE për së paku 10 vite me pjesë rezervë për autoambulancë dhe 7 vite për pajisje mjekësore.

Ne ofertë ju keni prezantuar dy dokumentet e me poshtme, ku asnjëra prej tyre nuk është nga prodhuesi siç është kërkuar:



20/06/2023
Gjakovë

Autoriteti Kontraktues: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
Operatori Ekonomik: **D&T Group SH.P.K.**
Numri i prokurimit: **206-23-5211-1-1-1**
Titulli: **Furnizim me autoambulanca**

DEKLARATË PËR SERVISIM DHE MIRËMBAJTJE

Ne **D&T Group SH.P.K.** deklarojmë se do të ofrojmë 3 vite garanci për pajisjet e ofruara (të gjitha pjesët e këmbimit, duke përfshirë përditësimet) 10 vite për pjesët rezervë për autoambulancë dhe 7 vite për pajisjet mjekësore.

Ne do të kryejmë servisimin e rregullt, mirëmbajtjen e rregullt si dhe riparimet e nevojshme gjatë periudhës garantuese, sipas manualit të përdorimit të Autoambulantes.

D&T GROUP SH.P.K.





Adresa: Magjistralja Prishtinë – Shkup, kilometri i III-të
Tel.: +383 45 501 901; +383 45 501 913
E-mail: sales@mercomcompany.com
Web: www.peugeot-ks.com
Facebook: www.fb.com/peugaokosova



Për: "D&T GROUP" SH.P.K

Ne lidhje me tenderin e poshtecekur:

AK: Ministria e Shendetesise

Titulli : "Furnizim me Autoambulanca"

Nr. i prokurimit : 206-23-5211-1-1-1

DEKLARATË

Ne, MERCOCOM COMPANY SH.P.K. si përfaqësues i autorizuar i brendit Peugeot për Republikën e Kosovës, konfirmojmë se ne do te ju ofrojmë furnizimin dhe mbështetjen e plotë me pjesë rezervë për automjetin Peugeot Boxer në afat prej 10 viteve pas dorëzimit të automjeteve.



Kriteri ka qene 10 vite me pjesë rezervë për autoambulancë ndersa 7 vite për pajisje mjekësore, Autorizimet qe ju i keni cekur Fazzini, Gima, Progetti jane per pajisje mjekësore, ndersa ju mungon nga Peugeot per autoambulance. Sa i perket autorizimeve (Fazzini, Gima, Progetti) ne kete faze nuk e kemi verifikuar origjinalitetin e tyre, duke marre parasysh dy arsyt tjera te eliminimit tuaj.

- Nuk pajtohemi me pretendimin e juaj ne lidhje me përshkrimin e kompetencave te komisionit dhe zyrtarit përgjegjës te prokurimit, ne i dimë ato dispozita shume me mire se ju dhe vendimi i ZPP është bazuar ne kompetencat dhe dispozitat ligjore, është dhënë arsyetimi ne raportin e vlerësimit, e kemi njoftuar ZKA dhe sigurisht se AK-MSH do ta trajtoj çështjen e vlerësimit jo profesional nga komisioni qe u ka rekomanduar për dhënie, shih me poshtë dispozitat ligjore:

Sipas nenit 59.4 te LPP-se: 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sipas nenit 39.11 te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK specifikohet se:

39.11 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit **mund të nxjerr vendimin përfundimtar** ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

Në si AK-MSh zotohemi që në rastin e ri-tenderimit do të zbuten kriteret dhe do të mund të plotësohen nga sa me shumë OE në konkurim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. "D & T Group" SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik të interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit